

## **Funksionet e Bashkisë**

Bashkia ka një sërë funksionesh në shumë fusha. Falë edhe procesit të decentralizimit të pushtetit lokal, këto funksione kanë ardhur duke u shtuar. Në bazë të Ligjit nr.8652, dt.31.07.2000, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (Kreu IV, neni 9, 10, 11, 12), Bashkia ushtron këto funksione:

### **Funksionet e Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike:**

1. Furnizimi me ujë të pijshëm;
2. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara;
3. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike;
4. Ndriçimi i mjediseve publike;
5. Funksionimi i transportit publik urban;
6. Administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit;
7. Shërbimi i dekorit;
8. Administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike;
9. Grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave;
10. Planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

### **Funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale:**

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

### **3. Funkcionet e Bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese:**

1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
3. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.
4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

### **4. Funkcionet e Bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit:**

1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

### **5. Funkcionet e Bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjisllacionit në fuqi.
4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të

balancuar gjinor.

5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **6. Funksonet e Bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor:**

1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.

2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.

3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.

4. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.

5. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.

6. Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

#### **7. Funksonet e Bashkisë në fushën e sigurisë publike:**

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

4. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësisve të vetë-qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

## **Funksionet e përbashkëta**

1. Komuna dhe bashkia kryejnë secilin nga funksionet e mëposhtme, veçmas ose së bashku me pushtetin qendror, në përputhje me afatet e përcaktuara në kreun XI të këtij ligji.

2. Në rastet kur pushteti qendror i kërkon komunës ose bashkisë kryerjen e një funksioni të përbashkët ose arritjen e një standardi kombëtar për realizimin e këtij funksioni, ai siguron mbështetje të mjaftueshme financiare dhe materiale.

3. Komuna dhe bashkia kryejnë këto funksione të përbashkëta për:

1. arsimin parashkollor dhe parauniversitar;
2. sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik;
3. kujdesin social, zbutjen e varfërisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse;
4. rendin publik dhe mbrojtjen civile;
5. mbrojtjen e mjedisit;
6. funksione të tjera të përbashkëta, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

4. Kompetencat e komunave dhe bashkive, për funksionet e parashikuara në këtë nen, rregullohen në çdo rast me ligj. Raportet mes njësisive të qeverisjes vendore dhe të institucioneve qendrore për funksionet e parashikuara në këtë nen, rregullohen me ligj ose me akte nënligjore.

## **Funksione dhe kompetenca të deleguara**

1. Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.
2. Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj.
3. Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë komunën, bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara të institucioneve qendrore, duke përcaktuar procedurat e kryerjes dhe të kontrollit për zbatimin e tyre.
4. Institucionet qendrore mund të autorizojnë komunën, bashkinë dhe qarkun të ushtrjnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.
5. Komunës, bashkisë ose qarkut, mund t'u delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.
6. Në çdo rast institucionet qendrore u garantojnë njësisive të qeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

7. Komuna, bashkia ose qarku, me nismën e tyre mund të përdorin burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të bashkësisë.